



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

**Nr. 125 Datë 29.08.2012**

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES ALBANIA”  
SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “g”, 5 pika 2, dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.08.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGIJE**

---

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.